



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KRYETARI

Nr. 3616 prot.

Himarë, më 02.07. 2024

URDHËR

Nr. 256 Datë 02/07/2024

PËR

**“KUFIZIMET E ORAREVE TË FURNIZIMIT TË BIZNESEVE GJATË SEZONIT
TURISTIK”**

Mbështetur në ligjin Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin Nr.139/2015 datë 17.02.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin Nr.10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjin Nr.8378/1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, VKM Nr.153/2000 “Rregullorja për zbatimin e kodit rrugor”, Udhëzimin e përbashkët Nr.7967/2018 “Mbi kufizimet në qarkullimin e mjeteve të rënda për transportin rrugor të mallrave përgjatë sezonit turistik dhe festave”, VKB Himarë Nr.1/2024 “Për miratimin e planit të punës, për menaxhimin e suksesshëm të sezonit turistik 2024 dhe planit të veprimit përkatës”, me qëllim sigurimin e një sezoni të qëndrueshëm, krijimin e një mjedisi miqësor për pushuesit vendas dhe të huaj, duke eliminuar trafikun që vjen si rezultat i aktivitetit të furnizimit:

URDHËROJ:

- 1- Të kufizohet qarkullimi i mjeteve rrugore për transportin e mallrave që shërbejnë për furnizimin e bizneseve në zonën turistike bregdetare të Bashkisë Himarë, për periudhën 03.07.2024-15.09.2024.
- 2- Subjektet që furnizojnë bizneset lejohen të kryejnë aktivitetin e furnizimit me mallrat të bizneseve në fashën orare 05⁰⁰-10⁰⁰ për periudhën e përcaktuar në pikën 1.
- 3- Subjektet të marrin masa për kryerjen e aktivitetit të furnizimit brenda fashës orare.
- 4- Për zbatimin e këtij urdhëri dhe marrjen e masave administrative ngarkohet, Drejtoria e Policisë Bashkiake Himarë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Arqilea Bollano

